



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Data	19.09.2025	Vendi	Kaçanik
Nj. org.		Nunri	
08-320/01-23712/25			

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

NJOFTIM

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari njofton fermerët e komunës së Kaçanikut për aplikim, në projektin – **mbështetja e fermerëve me serra në sipërfaqe prej 50m²**
Në këtë projekt do të përkrahen fermerët me serra në sipërfaqe prej 50 m² për kultivimin e kulturave perimore.

Kushtet e aplikimit:

- Të jetë banor rezident i komunës së Kaçanikut.
- Sipërfaqja e tokës ku do të ngritet serra, të jetë brenda teritorit të Komunës së Kaçanikut
- Të disponoj sasi të mjaftueshme të ujit për ujitje (mos llogaritja në shfrytëzimin e ujit të ujësjellësit).
- Fermeri të jetë i gatshëm të participoj në 20% vlerës së çmimit të serrës

Përparësi:

- Aplikuesit të cilët nuk janë përfitues të mëhershëm të ndonjë subvencioni komunal apo përkrahje tjetër, me serra.
- Familjet me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale
- Familjet me më pak të hyra, që shprehin gadishmëri me u marrë me këtë veprimtari

Afati i aplikimit: 22.09. 2025 deri më 10.10.2025

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formulari për aplikim
- Kopje e dokumentit identifikues
- Çertifikata e tokës (fleta poseduese)

Të interesuarit për më shumë informata mund të drejtohen në zyret e DBZHRP-së kati parë, në objektin e Administratës Komunale.



Drejtori i DBZHRP

Sulhad Bullovi